



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 11 Prot

Tiranë, më 08.02, 2013

**VENDIM Nr. 237, dt. 08.02.2013**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.02.2013 pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve HEC Gomsiqe 1 dhe HEC Gomsiqe 2, në Rrethin e Pukës - Subjekti "HEC GOMSIQE" sh.p.k., Tiranë,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve **"HEC Gomsiqe 1 dhe HEC Gomsiqe 2, në Rrethin e Pukës"**, paraqitur nga Subjekti **"HEC GOMSIQE" sh.p.k., Tiranë**.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër bazuar në kontratën dypalëshe midis **"HEC GOMSIQE" sh.p.k.** dhe **Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik**.
- III. Subjekti **"HEC GOMSIQE" sh.p.k.**, në bashkëpunim me struktura të MTKRS, të studjojë mundësinë e evidentimit dhe mbrojtjes së rrënojave të Kishës së Shna Ndout dhe Kuvendit të Etërve Françeskanë.
- IV. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori (**"HEC GOMSIQE" sh.p.k.**) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**ALDO BUMÇI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**ROLAND OLLI**

